



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 87_ Datë 31.08.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	DREJTORIA RAJONALE E SHËNDETËSISË DURRES
Hetim administrativ, iniciuar nga	<ul style="list-style-type: none">• APP <input type="checkbox"/>• Reklamim nga të tretë <input checked="" type="checkbox"/>
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	<p>Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ dhe kundërshtimeve të dërguara nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Prokurimit Publik arrin në përfundimin se, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përlogaritjen e fondit limit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 28, pika 3, të Ligjit të Prokurimit Publik dhe nenin 59 të Rregullave të Prokurimit Publik.</p> <p>Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të kualifikimit, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 61 të Rregullave të Prokurimit Publik.</p> <p>Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka hartuar specifikime teknike, në kundërshtim me nenin 23, pika 5, të Ligjit të Prokurimit Publik, pasi ka përcaktuar llojin e markës së tonerave.</p> <p>Autoriteti kontraktor ka refuzuar ofertat e paraqitura nga ofertuesit, për shkak se nuk kanë në fushën e veprimtarisë, objektin e prokurimit në kundërshtim me nenin 40, të Rregullave të Prokurimit Publik.</p>

	nenin 40, të Rregullave të Prokurimit Publik.
Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit të Prokurimit Publik, ka propozuar për marrjen e masës disiplinore për 3 (tre) persona, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.